

VENDIM
Nr. 66, datë 29.7.2014

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË POSAÇËM Z.
ARBEN SEFERAJ, ADMINISTRATORI I
PËRKOHSHËM I SHOQËRISË OPERATORI I
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
(OSHEE) SHA, QË TË KETË TË GJITHA
KOMPETENCAT PËR NDJEKJEN E
PROCEDURAVE TË NEVOJSHME PËR
SIGURIMIN DHE NËNSHKRIMIN E GARANCISË
BANKARE, SI DHE INSTRUMENTEVE TË TJERA
FINANCIARE TË DOMOSDOSHME PËR
PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË MARRËVESHJES
SË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË CEZ AS, TË
DATËS 23 QERSHOR 2014

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit nr. 5, datë 21.1.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe

aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., vendimit nr. 118, datë 18.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për emërimin e administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, si dhe nenit 11, pika 1, e rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.7.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dërguar me shkresën nr. 8853, datë 29.7.2014 (nr. prot. hyrës 565, datë 29.7.2014.) “Kërkesë për lëshimin e autorizimit për sigurimin e garancisë bankare konform përcaktimeve të Settlement Agreement”.

VENDOSI:

1. T’i jepet autorizim i posaçëm z. Arben Seferaj, administrator i përkohshëm i shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., që të ketë të gjitha kompetencat për ndjekjen e procedurave të nevojshme për sigurimin dhe nënshkrimin e garancisë bankare, si dhe instrumenteve të tjera financiare të domosdoshme për plotësimin e kushteve të Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “CEZ” a.s., të datës 23 qershor 2014, Marrëveshje e konfirmuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë edhe me shkresën nr. prot. hyrës 565, datë 29.7.2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

